

ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË

25 PRILL 2021

DEKLARATA E GJETJEVE DHE PËRFUNDIMEVE PARAPRAKE

Përgatiti: ©  **KRIIK** KOALICIONI PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA

Të drejtat e botimit të këtij Dokumenti janë të rezervuara.

Pjesë të këtij materiali **mund të përdoren lirisht**. Në një rast të tillë lutemi citoni burimin.

A: Rr. "Ymer Kurti", Nd.4, H.2, Ap.3, Nj.Adm.5, Tirana, 1019 | Mailing Address: P.O.Box. 2396 Tirana, 1001, Albania;

Aksioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve i KRIIK për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të 25 Prillit 2021 mbështetet financiarisht nga:

- Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar;
- Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)
- Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës Federale të Gjermanisë dhe
- Ministria e Punëve të Jashtme e Dukatës së Madhe të Luksemburgut.

Opinionet dhe këndvështrimet e shprehura në këtë Raport dhe në çdo publikim tjetër në kuadër të këtij aksioni vëzhgimi, janë përgjegjësi e KRIIK dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pozicionin zyrtar apo opinionin e donatorëve.

PERFUNDIME PARAPRAKE

Procesi zgjedhor që kulminoi me Ditën e Zgjedhjeve në 25 prill 2021 u mbajt në një situatë tejet të polarizuar e konfliktuale si në rrafshin politik, ashtu edhe në atë institucional. Blerja e votës, intimidimi i zgjedhësve dhe të tjera krime zgjedhore ishin temë e ditës gjatë fushatës, duke u rritur në intensitet me afrimin e ditës së zgjedhjeve. Polarizimi i tejskajshëm përshkallëzoi më tej situatën deri në konflikte dhe dhunë fizike mes apo ndaj mbështetësve të disa subjekteve zgjedhore, duke shënuar sulme fizike e deri në një humbje jete, vetëm katër ditë përpara ditës së zgjedhjeve.

KRIIK vlerëson pozitivisht faktin që kjo retorikë e ashpër politike dhe incidentet që shoqëruan ditët e fundit fushatën u ndalën dhe nuk njollosën ditën e zgjedhjeve.

Kuadri ligjor përbën dhe jep garanci për të zhvilluar një proces zgjedhor me standarde, gjithmonë nëse vullneti politik kryesor dhe administrues është konstruktiv e ligjzbatues.

Kuadri ligjor zgjedhor ndryshoi në shumë elementë të tij përpara Zgjedhjeve të 25 prillit, nëpërmjet dy ndërhyrjeve madhore, në korrik dhe tetor të vitit të shkuar. Ndërsa ndryshimet ligjore të korrikut 2020 patën konsensus politik nga partitë e mëdha, transparenca dhe konsultimi me aktorët e shoqërisë civile dhe partitë më të vogla ishte i munguar.

Akoma më tepër u cënuan parimet e konsultimit publik dhe të transparencës me amendimet e njëanshme Kushtetuese të korrikut 2020, pasuar nga amendimet ligjore të tetorit 2020, të cilat gjithashtu cënuan edhe besimin e vendosur të palëve në Marrëveshjen e 5 qershorit. Për më tepër, këto ndërhyrje nuk ishin në linjë me kodin e praktikave të mira për zgjedhje demokratike, duke qenë se përbënin ndryshime madhore të kuadrit ligjor zgjedhor më pak se një vit përpara zgjedhjeve.

Institucionet e shëndetit publik u treguan të ngadaltë dhe pasivë në adresimin e rregullave që duhet të ndiqen lidhur me mbajtjen e zgjedhjeve gjatë pandemisë. Rregullimi i duhur ligjor, për sa mund të quhet i tillë, u bë vetëm 24 ore përpara ditës së votimit.

Pragu ligjor prej 1% në nivel kombëtar për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit vlerësohet të përbëjë një barrierë për mundësinë konkrete për t'u zgjedhur për këta kandidatë që mbështeten drejtpërdrejt nga zgjedhësit, ndërkohë që edhe logjikisht konsiderohet i tepërt e i pavend, pasi këta kandidatë garojnë vetëm në një zonë zgjedhore, ndërsa rezultati iu kërkohet për të 12 zonat zgjedhore.

Institucioni i ridimensionuar i KQZ-së, evidentoi në tërësi përgjegjshmëri dhe transparencë në organizim, funksionim dhe vendimmarrje, si dhe një qasje pozitive bashkëpunimi me aktorët politikë, ata të shoqërisë civile dhe median.

Vlerësohet se administrimi i aspekteve teknike të procesit zgjedhor nga KQZ-ja ishte më së shumti eficient dhe me transparencë të rritur. Megjithatë, KRIIK vëren se të treja organet drejtuese të KQZ-së, reflektuan në vijimësi një sjellje që nuk është ajo e një institucioni të vetëm, por e tre trupave të ndara funksionalisht nga njëra-tjetra.

Vendimmarrja e Komisionit Rregullator vlerësohet pozitivisht për marrjen e saj në unanimitet dhe me konsensus prej të gjithë anëtarëve, megjithëse, në disa raste, në diskutimet e tyre janë evidentuar edhe qasje të njëanshme politike, çka ndikoi edhe në heqjen dorë prej tij nga detyrimi për miratimin e fletës së votimit.

Vendimmarrja e KAS konsiderohet si e marrë në një lexim të ngushtë të ligjit, dhe në një qasje të larguar prej së qeni pjesë e organeve drejtuese të KQZ-së, të cilit Kodi Zgjedhor i jep kompetencën për vendosjen e sanksioneve për shkelje të ligjit zgjedhor. Vendimmarrja e tij, zbehu dhe zhbëri tërë ndryshimet dhe efikasitetin e instrumentit të ngritur për të parandaluar dhe sanksionuar përdorimin abuziv të burimeve shtetërore.

Sjellja e KAS dhe Rregullatorit u evidentua të ishte e ndikuar politikisht, çka u vërejt qartazi në qëndrimet e shprehura nga anëtarët e këtyre komisioneve për çështje në të cilat partitë politike patën qëndrime të ndara.

Vlerësohet pozitivisht përpjekja e KQZ-së për konkretizimin e përdorimit të teknologjisë në këto zgjedhje, referuar këtu realizimin e identifikimit elektronik të zgjedhësve në të gjithë vendin, monitorimin me kamera të të gjitha qendrave të votimit, si dhe projektin pilot të votimit dhe numërimit elektronik në Tiranë, pavarësisht anomalive të vërejtura përgjatë ditës së votimit me funksionimin e PEI-t.

Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor vlerësohet të kenë patur një ecuri përgjithësisht pozitive dhe të kenë administruar në mënyrë përgjithësisht eficiente procesin zgjedhor, pavarësisht vështirësive të ardhura nga mungesa e infrastrukturë dhe materialeve të nevojshme në një pjesë të tyre.

Shqetësues mbetet ndryshimi i anëtarëve të KZAZ-ve dhe KQV-ve përgjatë gjithë procesit zgjedhor, si dhe trajnimi i duhur i tyre.

Formimi i Komisioneve të Qendrave të Votimit dhe Grupeve të Numërimit të Votave ishte një proces i realizuar në tejkallim të afateve ligjore, për shkak të vonesave të shkaktuara nga partitë politike dhe mos depozitimit prej tyre të propozimeve për anëtarë të këtyre komisioneve.

Procesi i hartimit të listës së zgjedhësve nuk u shoqërua me transparencën e duhur, ndërkohë që edhe në këto zgjedhje procesi i njoftimit me shkrim të zgjedhësve vuajti nga moszbatimi sipas kriterëve dhe parashikimeve ligjore, duke shënuar disa problematika në lidhje me publikimin e tyre dhe informimin e qytetarëve.

Lidhur me të drejtën e zgjedhësve shqiptarë që kanë vendbanimin e përhershëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, përpjekja për t'ua siguruar atë dështoi, çka është një rast i humbur si dhe një shkelje e angazhimeve politike të palëve, sipas marrëveshjes së 5 qershorit 2020.

Numri i firmave mbështetëse që duhet të paraqiten nga partitë jo parlamentare dhe kandidatët e pavarur, megjithëse në përputhje me praktikën e mira të zgjedhjeve, evidentoi se përbënte një barrierë veçanërisht për kandidimin e kandidatëve të pavarur. Nga tetë komisione nismëtare të regjistruara në KQZ, vetëm pesë arritën të mblidhnin firmat e kërkuara, tre prej të cilëve patën mundësinë të përdornin burimet e një strukture organizative ekzistuese.

Pavarësisht se ishte lehtësisht e parashikueshme që zgjedhjet e 25 prillit 2021 do të zhvilloheshin në situatë pandemie, partitë politike në asnjë moment nuk e bënë këtë çështje pjesë të diskutimit në Këshillin Politik. Shteti shqiptar dështoi të plotësonte detyrimin për t'iu garantuar të gjithë shtetasve të vet të drejtën e votës, një e drejtë e pamohueshme dhe e pacënueshme që Konventat Ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar dhe Kushtetuta e vendit iua njohin shtetasve.

Vetëizolimi i detyruar i qytetarëve që mund të vinin nga Greqia apo Maqedonia, ishte një tjetër kufizim dhe cënim i së drejtës të votës dhe nuk mund të justifikohet asesi me argumentin e dhënë nga Komiteti Teknik për marrjen e tij.

Kuadri ligjor parashikon se fushata zgjedhore fillon 30 ditë përpara ditës së votimit, gjatë së cilës partitë politike janë të detyruara të veprojnë sipas rregullave të përcaktuara nga Kodi Zgjedhor. Megjithatë kjo nuk i pengoi subjektet zgjedhore të nisnin fushatën muaj më herët sesa parashikimi i ligjit. Vakumi ligjor në mos përkufizimin e saktë e të plotë të fushatës zgjedhore, iu lë hapësirë subjekteve zgjedhore që të fillojnë fushatën e tyre *de facto*, me të gjithë karakteristikat që ajo përmban.

Madje, dy partitë kryesore e hapën fushatën e tyre zyrtarisht në datë 25 mars, sërish në shkelje të dispozitave ligjore dhe në shkelje të urdhrit të Ministrisë së Shëndetësisë, për mos lejimin e tubimeve dhe grumbullimeve të më shumë se 10 personave.

Retorika e ashpër, gjuha denigruese ndaj kundërshtarit, akuzat dhe kundërakuzat për blerje vote karakterizuan fushatën në linjë me sjelljen e subjekteve zgjedhore në fushatën e parakohshme. Krijimi i këtij debati pa përmbajtje, gjatë fushatës elektorale, veçse solli anashkalimin e vëmendjes nga planet dhe programet konkrete të partive politike garuese në këtë proces, të cilat nga ana tjetër munguan dhe nuk u bënë formalisht publike.

Me një retorikë të ashpër në fushatën elektorale u përfshi edhe Presidenti i vendit, i cili u angazhua haptas në fushatë kundër maxhorancës aktuale dhe, personalisht, Kryeministrit Rama, duke u pozicionuar si një konkurrent elektorale dhe jo si një figurë mbi palët.

Policia e Shtetit nuk mbajti asnjë qëndrim dhe nuk ndërmori asnjë masë ndëshkimore ndaj partive politike garuese në zgjedhje për shkeljen e masave kufizuese kundër pandemisë. Ndërkohë, një sjellje totalisht e ndryshme u konstatua ndaj dy kandidatëve të pavarur, të cilët u gjorbitën për shkelje të rregullave kundër tubimeve, duke shkelur parimin e barazisë në garë për konkurrentët zgjedhorë.

Ngritja e të ashtuquajturës Strukturë për Mbrojtjen e Votës nga Partia Demokratike konsiderohet gjithashtu si një fenomen shqetësues. Kjo “strukturë”, e paqartë se nga cili përbëhet dhe si drejtohet konsiderohet një formë parashtetërore dhe aspak e shëndetshme për ligjzbatimin, sjelljen institucionale dhe ndërtimin dhe funksionimin e një shteti ligjor e të së drejtës.

Retorika e ashpër politike që parapriu dhe ndoqi incidentet e ndodhura dhe mosdistancimi i partive politike nga ushtruesit e veprimeve të dhunshme, madje, përkundrazi, duke justifikuar apo mohuar lidhjen me këta individë konsiderohet të jetë tejet problematike si sjellje dhe qasje.

Në takimet elektorale të zhvilluara është vërejtur një prani e konsiderueshme e zyrtarëve të lartë të administratës publike, të cilët kanë qenë të shoqëruar edhe nga zyrtarë të lartë lokalë. Përveç faktit

që kanë qenë të pranishëm në këto aktivitete elektorale përgjatë orarit zyrtar të punës, një pjesë e tyre kanë qenë të angazhuar në evente edhe si folës apo protagonist, çka përbën shkelje të kuadrit ligjor zgjedhor apo edhe të statusit të nëpunësit publik.

Pjesëmarrja e të miturve në eventet elektorale, të shoqëruar nga familjarë si pjesë e audiencës apo duke mbajtur të veshur simbole partiake apo të fushatës, edhe në këtë proces zgjedhur nuk mungoi. Ndonëse më pak i vërejtur se në fushatat e mëparshme zgjedhore, mbetet një fenomen shqetësues i cili duhet adresuar dhe parandaluar në mënyrë të plotë.

Kuadri ligjor nuk përfshin detyrimin e subjekteve zgjedhore për të bërë transparencë të financimeve gjatë procesit zgjedhor dhe veçanërisht gjatë fushatës zgjedhore. Thirrjes së KRIIK për transparencë dhe deklarim vullnetar të shpenzimeve, nuk iu përgjigj asnjë subjekt elektorale dhe asnjë kandidat.

Publikimi i raporteve të monitorimit të fushatës zgjedhore nga monitoruesit e KQZ-së ka qenë thuajse inekzistent në përgjithësi dhe totalisht i munguar gjatë fushatës zgjedhore, çka ka sjellë transparencë të reduktuar, mbi një mekanizëm i cili ishte jo eficient qysh në ngjizjen e vet. Mund të konkludohet se mekanizmi, i cili synon rritjen e transparencës mbi aktivitetet e fushatës zgjedhore, dështoi të arrijë funksionin e vet primar, transparencën në funksion të zgjedhësve. Kjo mbetet veçanërisht problematike nëse merret në konsideratë se partitë nuk kanë detyrimin ligjor për të raportuar përpara ditës së zgjedhjeve, madje deklarimi prej tyre i financimeve dhe i auditimit të tyre bëhet muaj më pas mbas çertifikimit zyrtar të rezultatit përfundimtar.

Fushata elektorale, duket se i zbuti disi tonet e aktorëve politike, për sa i përket sulmeve ndaj medias. Megjithatë u evidentuan raste sporadike të përmendjes së medias si një pushtet i kapur nga politika, apo edhe raste të sulmeve ndaj gazetarëve apo edhe vetë mediave.

Autoriteti i Medias Audiovizive nuk përcaktoi afate për kompensimin e minutazhit të munguar që disa media detyroheshin të pasqyronin në favor të një subjekti zgjedhor. Mospërcaktimi i një afati të qartë për kompensimin, brenda afatit zyrtar të përfundimit të fushatës elektorale, dhe bartja e këtyre shifrave pas mbarimit të saj, tregojnë për një ngërç në funksionimin e mekanizmit të mbikëqyrjes së mediave, dhe e zhvlerësojnë atë dhe parimet mbi të cilat është ngritur ai.

Gjatë ditës së zgjedhjeve, procesi i votimit ishte i qetë dhe proceduralisht u administrua përgjithësisht mirë, me përjashtim të disa problematikave, kryesisht me Pajisjen Elektronike të Identifikimit në një numër jo të vogël qendrash votimi.

Incidentet sporadike të ndodhura, për aq sa është informuar dhe trajtuar, gjykohet se nuk e ndikuan integritetin e procesit të votimit. Shqetësues mbetet ndikimi i paligjshëm dhe format e ndryshme të intimidimit të zgjedhësve në afërsi të qendrave të votimit, në linjë me indikacionet për struktura të organizuara të drejtimit të votës, siç është bërë me dije në raportet e ndërmjetme të KRIIK dhe gjerësisht në media.

DITA E ZGJEDHJEVE DHE NISJA E NUMERIMIT TE VOTAVE

Procesi i votimit

Procesi i votimit ishte i qetë dhe proceduralisht u administrua mirë, me përjashtim të problematikave me Pajisjen Elektronike të Identifikimit në një numër qendrash votimi. Incidentet sporadike të ndodhura, gjykohet se nuk e ndikuan integritetin e procesit. Shqetësues mbetet ndikimi i paligjshëm dhe i paduhur i zgjedhësve në afërsi të qendrave të votimit, në linjë me indikacionet për struktura të organizuara të drejtimit të votës, siç është bërë me dije në raportet e ndërmjetme të KRIIK dhe gjerësisht në media.

Hapja e qendrave të votimit

Procesi i hapjes së qendrave të votimit vuajti nga vonesat e hapjes përtej afatit ligjor, kryesisht si pasojë e vështirësive me aktivizimin e pajisjeve elektronike të identifikimit (PEI). Vetëm në 66.3% të qendrave të votimit procesi i votimit nisi në orar (7:00). Shumica e qendrave të votimit që u hapën me vonesë patën një vonesë prej më pak se gjysmë ore (25.5% e totalit u hapën mes orës 7:00 dhe 7:30) dhe 8.2% u hapën me vonesa mbi gjysmë ore. Në thuajse gjysmën e qendrave të votimit që u hapën me vonesë (48.2%) kishte zgjedhës që prisnin në radhë për të votuar në momentin e hapjes së QV-së.

Prania e komisionerëve të qendrës së votimit në orën e hapjes ishte e plotë (shtatë komisionerë) në pjesën më të madhe të QV-ve (76.9%).

Në shumicën e rasteve, vëzhguesit e KRIIK vlerësuan se organizimi i qendrës së votimit garantonte fshehtësinë e votës. Vetëm në dy qendra votimi vëzhguesit gjykuan se fshehtësia e votës nuk garantohej nga organizimi i qendrës së votimit. Në dy qendra të tjera votimi vëzhguesit vlerësuan se lëvizja e lirshme e zgjedhësve nuk garantohej nga organizimi i mjedisit të QV-së.

Kutitë e votimit u mbyllën në prezencë të të gjithë anëtarëve të pranishëm në QV dhe vëzhguesve në të gjithë qendrat e votimit.

Në dy prej qendrave të votimit u nis procesi i votimit në mungesë të kamerës apo pajisjes elektronike të identifikimit, pasi operatorët nuk u paraqitën në detyrë (në njërin rast kamera dhe në tjetrin PEI).

Procedurat e hapjes së qendrave të votimit u vlerësuan si shumë të mira në 66.3% të qendrave të votimit, të mira në 27.7% të qendrave të votimit dhe si problematike në 6.1% të tyre.

Procesi i votimit

Procesi i votimit u administrua mirë nga pikëpamja procedurale në shumicën e qendrave të votimit. Ndërkohë, si problematike, në 6% të qendrave të votimit u konsiderua prezenca e shtuar e individëve në afërsi të QV-ve, prezencë e cila ishte veçanërisht problematike në disa QV¹.

Gjithashtu problematike ishte prania e personave të paautorizuar brenda qendrave të votimit, fenomen që u vërejt në 7% të tyre. Personat e paautorizuar në shumicën e rasteve u identifikuan si përfaqësues të forcave politike. Në 4.5% të qendrave të votimit u vërejtën persona që bënin propagandë aktive në afërsi të tyre, në kundërshtim të hapur me kuadrin ligjor.

Rezultoi se 87.2% e qendrave të votimit funksionuan me praninë e plotë të të gjithë anëtarëve të komisionit (7 anëtarë), ndërkohë që në 12.8% të tyre kishte mungesa të anëtarëve. Të gjithë komisionet, megjithatë, funksionuan me më shumë se gjysma e anëtarëve të komisionit.

Përgjatë ditës, organizimi i mjedisit të qendrave të votimit u evidentua të ishte më problematik sesa mund të gjykohej gjatë momentit të hapjes së QV-së. Konkretisht, në 10.1% të qendrave të votimit, dhoma e fshehtë nuk mund të shihej me lehtësi nga të gjithë vëzhguesit dhe anëtarët e komisionit dhe në 4.8% ishte e vështirë të shihej kutia e votimit gjatë kohës që kishte zgjedhës brenda në QV.

Posterët shpjegues me të cilat KQZ kishte pajisur të gjitha qendrat e votimit (postera shpjegues të procedurave të votimit dhe postera me emrat e kandidatëve për subjekt politik) nuk ishin të afishuar në të gjitha qendrat e votimit, çka uli mundësinë për informimin e duhur të qytetarëve. Konkretisht, në 7% të qendrave të votimit mungonin posterët me procedurat e votimit dhe në 6.5% munguan posterët me emrat e kandidatëve. Po ashtu dhe listat e zgjedhësve nuk ishin të afishuara në 7% të qendrave të votimit.

Gratë u konstatua se përbënin një numër shumë të ulët të komisionerëve të qendrave të votimit. Në 72.6% të qendrave të votimit burrat ishin në shumicë ndaj grave komisionere. Në 19.9% nuk kishte asnjë anëtar të komisionit grua dhe në 52.7% të qendrave të votimit kishte një ose dy gra anëtare të komisionit.

Nga pikëpamja procedurale, përgjithësisht në shumicën e rasteve procedurat u ndoqën me përpikmëri nga komisionet e qendrave të votimit. Shkelje u evidentuan në një numër të vogël qendrash votimi. Të tilla përfshijnë moskontrollimin e zgjedhësve në të dyja duart nëse ishin timbrosur më parë (5 QV), raste sporadike të lejimit të zgjedhësve të votonin pa paraqitur dokument identifikimi (3 QV), raste të zgjedhësve që votonin pa u timbrosur me bojën e posaçme (5 QV), e të tjera. Shqetësues mbeti lejimi i zgjedhësve që të mund të përdornin telefonin celular brenda qendrës së votimit (8% e QV-ve) apo edhe në dhomën e fshehtë (5.1%).

Njohja dhe zbatimi i procedurave nga anëtarët e komisioneve të qendrave të votimit u vlerësua si shumë e mirë në 70.2% të qendrave të votimit, si i mirë në 26.8% të tyre dhe si problematike në 3% të tyre.

¹ Në zonën e Durrësit, tek ish-këneta.

Votimi familjar vijon të mbetet një problem madhor, i identifikuar në 24.2% të qendrave të votimit. Ndërkohë, akoma më shqetësues është fakti se janë vërejtur zgjedhës që kanë fotografuar votën apo tentuar ta fotografojnë atë në 2.4% të qendrave të votimit.

Njohja e procedurave prej zgjedhësve u vlerësua si shumë e mirë në 54.2% të qendrave të votimit, si e mirë në 32.1% të tyre, si problematike në 12.5% dhe shumë problematike në 1.2%.

Gjithashtu shqetësues vazhdon të mbetet fenomeni i shkeljes së procedurave ligjore për shoqërimin dhe asistencën e zgjedhësve të cilët kërkojnë të asistohen gjatë votimit, çka dëmton fshehtësinë e votës. Konkretisht, në 8.9% të qendrave të votimit, personat që kanë asistuar një zgjedhës janë lejuar ta bëjnë këtë pa plotësuar deklaratën përkatëse me anë të së cilës ata deklarojnë se nuk kanë shoqëruar të tjerë zgjedhës, se do të respektojnë vullnetin e zgjedhësit që asistojnë dhe se nuk do të çenojnë fshehtësinë e votës së tij. Akoma më shqetësuese, në 2.4% të qendrave të votimit u vërejtën individë të cilët asistuan më tepër se një zgjedhës gjatë votimit dhe në 2% u vërejtën anëtarë të KQV-së të cilët asistuan këta zgjedhës.

Në 23.2% të qendrave të votimit u paraqitën zgjedhës të cilët nuk mundën të votonin, për arsye të ndryshme. Në 69.2% të rasteve arsyeja ishte se nuk kishin emrin në listë dhe duhet të shkonin në një tjetër qendër votimi (çka tregon një nivel të ulët të informimit të zgjedhësve) dhe në 21.8% arsye ishte fakti se nuk kishin dokument identifikimi. Në një qendër votimit, vëzhguesit kanë raportuar se një zgjedhës me kartë identiteti të skaduar nuk është lejuar të votojë, në kundërshtim me VKM-në që shtynte afatin e kartave të identitetit të skaduara deri në fund të prillit.

Mosfunksionimi i PEI në mënyrën e duhur solli ndërprerje në një numër qendrash votimi, duke u shoqëruar, në disa raste me kalimin në procedurën manuale të identifikimit të zgjedhësve. Në 19.6% të qendrave të votimit pati probleme, të llojeve të ndryshme, me funksionimin e PEI-t.

Në 46.4% të qendrave të votimit aksesimi për personat me aftësi të kufizuara lokomotore u vlerësua si i vështirë prej vëzhguesve (QV-të ose ishin të papërshtatshme për akses ose ishin pjesërisht të përshtatshme), çka përbën një barrierë madhore për garantimin e ushtrimit të së drejtës së votës për këta qytetarë. Në 94.6% të rasteve, personat e verbër që u paraqitën për të votuar në qendrën e votimit u asistuan nga persona të tjerë dhe vetëm në 5.4% u përdorën fletët e votimit Braille. Madje, edhe kur të tilla u përdorën, sërish në shumicën e rasteve zgjedhësit përdorën edhe asistencën e personave të tretë, duke mos votuar në mënyrë të pavarur.

Pati një numër të lartë qendrash votimi në të cilat pajisja elektronike e identifikimit nuk arriti të identifikonte shenjën e gishtit të zgjedhësve dhe zgjedhësit votuan duke firmosur në listën e zgjedhësve (8.9% e qendrave të votimit).

Prania e materialeve propagandistikë brenda në qendrën e votimit ishte një problem i vërejtur në një numër qendrash votimi, përgjithësisht në formën e zgjedhësve që u paraqitën në QV duke mbajtur veshje me simbole apo slogane elektorale².

² Madje edhe vetë Kryeministri Rama votoi me një kapelë me numrin 12 të PS në fletën e votimit, të njëjtën që ka përdorur gjatë fushatës.

Një problem shumë shqetësues për KRIIK gjatë ditës së votimit ka qenë pengimi i vëzhguesve të pavaruar, në forma të ndryshme, për të vëzhguar procesin, në kundërshtim të hapur me kuadrin ligjor. Përgjithësisht, pengimi erdhi në formën e komisionerëve që nuk lejonin vëzhguesit të vëzhgonin, duke demonstruar një mosnjohje të drejtave të vëzhguesve. Në 2.7% të qendrave të votimit u identifikuan pengesa të tilla.

Procedurat e mbylljes së qendrës së votimit

Mbyllja e qendrave të votimit u realizua, përgjithësisht, në linjë me procedurat, me devijime të vogla në raste sporadike, të cilat gjykohet të mos e kenë cënuar integritetin e procesit.

81% e qendrave të votimit u mbyllën në kohë, ndërkohë që vonesat në mbyllje ishin më pak se gjysmë ore në thuajse të gjithë QV-të e tjera, me përjashtim të 6 QV-ve që u mbyllën mes orës 19:30 dhe 20:00. Në asnjë rast nuk pati zgjedhës që të kishin mbërritur pas orës 19:00 dhe që të mos lejoheshin të votonin.

Materialet zgjedhore u vulosën sipas procedurave dhe në prani të komisionerëve dhe vëzhguesve në të gjithë qendrat e votimit.

Procedurat e mbylljes së qendrave të votimit u vlerësuan si shumë të mira në 75% të qendrave të votimit, të mira në 24% të tyre dhe si problematike në më pak se 1%. Në rastin e fundit, vëzhguesit gjykuan se problematikat vinin nga neglizhenca dhe nuk ishin të qëllimshme.

Dorëzimi i materialeve zgjedhore në VNV

Përfaqësimi politik nga grupet e marrjes në dorëzim të materialeve të votimit është zbatuar në 100% të rasteve. Në 98.8% të VNV-ve vëzhguesit gjykuan se hapësira për marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore ishte e mjaftueshme. Vëzhguesit në KZAZ kanë raportuar se marrja në dorëzim u realizua sipas procedurave të parashikuara dhe në përputhje me Kodin Zgjedhor në të gjitha VNV-të. Procedurat për administrimin dhe ruajtjen e kutive të parregullta u zbatuan gjithashtu.

Një problematikë madhore në lidhje me procedurat e marrjes në dorëzim të materialeve zgjedhore ishte moslejimi i vëzhguesve për të vëzhguar nga afër këtë proces. Ky është një fenomen që përsëritet në çdo raund zgjedhor, në një pjesë të konsiderueshme të vendeve të numërimit të votave.

Nisja e procesit të numërimit

Procesi i numërimit nisi në orët e fundit të mbrëmjes të së dielës dhe ka përfunduar në së paku 13 ZAZ deri në orën 13:00 të datës 26 prill³.

Pavarësisht se ishte parashikuar që procesi i numërimit të vazhdonte pa ndërprerje, me grupe numëruesish që zëvendësohen pas numërimit të një numri qendrash votimi, me qëllim shmangien e bllokimit abuziv të procesit, sërish në këto zgjedhje ka patur ndërprerje të numërimit, duke sjellë si argument lodhjen e komisionerëve. Ka patur ndërprerje të procesit të numërimit, me kohëzgjatje të ndryshme, në së paku 28 KZAZ⁴. Përveç argumentit të lodhjes, ka patur dhe raste kur numërimi u ndërpre për probleme teknike⁵.

Vëzhguesit e KRIIK nuk janë lejuar të hyjnë në disa prej Vendeve të Numërimit të Votave edhe pse procesi i dorëzimit të materialeve zgjedhore kishte përfunduar. Ky fenomen i vërejtur here pas here në çdo proces zgjedhor prej vullnetit të KZAZ-ve, mbetet një fenomen tejet shqetësues, i cili tregon së paku mosnjohje të kuadrit ligjor apo injorim të tij nga KZAZ-të. Akoma më shqetësues është fakti se në disa KZAZ nuk janë pranuar as vëzhguesit e subjekteve zgjedhore⁶.

Në ambientet e Vendeve të Numërimit të Votave, është vërejtur prezencë e lartë vëzhguesish të partive politike⁷, madje në disa raste nga KZAZ është kërkuar ndërhyrja e komisionit dhe policëve.

Raste të konflikteve verbale midis vëzhguesve të partive politike dhe anëtarëve të GNV-ve ka patur në disa⁸ VNV, madje është kërkuar edhe ndërhyrja e KZAZ-së përkatëse⁹ për të zgjidhur situatën e krijuar.

³ KZAZ nr. 92 Bashkia Konispol, KZAZ nr. 88 Bashkia Himarë, KZAZ nr. 9 Bashkia Tropojë, KZAZ nr. 67 Bashkia Poliçan, KZAZ nr.92 Bashkia Konispol, KZAZ nr. 8 Bashkia Fushe Arrës, KZAZ nr. 71 Bashkia Pustec, KZAZ nr. 78 Bashkia Memaliaj, KZAZ nr. 7 Bashkia Pukë, KZAZ nr. 77 Bashkia Këlcyrë, KZAZ nr. 76 Bashkia Përmet, KZAZ nr. 78 Bashkia Memaliaj, KZAZ nr. 75 Bashkia Kolonjë.

⁴ KZAZ nr. 25 Bashkia Shijak, KZAZ nr. 63 Bashkia Dimal, KZAZ nr. 77 Bashkia Këlcyrë, KZAZ nr. 78 Bashkia Memaliaj, KZAZ nr. 79 Bashkia Tepelenë, KZAZ nr. 80 Bashkia Gjirokastër, KZAZ nr. 81 Bashkia Libohovë, KZAZ nr. 82 Bashkia Dropull, KZAZ nr. 26 Bashkia Vorë, KZAZ nr. 29, nr. 30, nr. 33, nr. 31, nr. 34, nr. 39, nr. 41 Bashkia Tiranë, KZAZ nr. 13 Bashkia Lezhë (procesi ka rifilluar), KZAZ nr. 15 Bashkia Kurbin, KZAZ nr. 69 Bashkia Pogradec, KZAZ nr. 89 Bashkia Delvinë, KZAZ nr. 90 Bashkia Sarandë, KZAZ nr. 64 Bashkia Kuçovë, KZAZ nr. 61 Bashkia Roskovec, KZAZ nr. 55 Bashkia Lushnje, KZAZ nr. 15 Bashkia Kurbin, KZAZ nr. 57 Bashkia Fier, KZAZ nr. 27 Bashkia Kamëz, KZAZ nr. 21 dhe nr. 24 Bashkia Durrës.

⁵ KZAZ nr. 7 Bashkia Pukë, KZAZ nr. 84 Bashkia Vlorë,

⁶ Moslejimi i vëzhguesve të pavarur, përfshirë vëzhguesin e KRIIK, si dhe vëzhguesin e subjektit politik “Aleanca Demokracia e Re”, në KZAZ nr. 34 Bashkia Tiranë, ka sjellë konflikt verbal ndërmjet policisë dhe këtyre vëzhguesve. Procesi I numërimit në këtë KZAZ ka filluar 45 minuta përpara se vëzhguesit të futeshin në sallë. Gjithashtu, vëzhguesit e kandidatit të pavarur Elton Debreshi nuk janë lejuar të hyjnë në KZAZ në Dibër dhe në Bulqizë, çka u përcoll edhe në media.

⁷ KZAZ nr. 70 Bashkia Maliq, KZAZ nr. 63 Bashkia Ura Vajgurore.

⁸ KZAZ nr. 36 Bashkia Tiranë është kërkuar rinumërim nga PD, KZAZ nr. 22 Bashkia Durrës vëzhguesit e PD janë konfliktuar verbalisht me anëtarët e Grupit të Numërimit të Votave,

⁹ KZAZ nr. 65 Bashkia Berat kandidati I koalicionit ABEOK është konfliktuar verbalisht me anëtarët e GNV dhe situata është zgjidhur vetëm pas ndërhyrjes së KZAZ. KZAZ nr. 70. Bashkia Maliq pati kontestim të rezultatit të QV nr. 3775 për pretendime të mospërputhjes së numrit të fletëve të votimit me numrin e votuesve. Ky problem u referua në KQZ. Në KZAZ 73, komisionerët janë konfliktuar me pretendimin se në një kuti votimi ka patur disa vota tepër për PS.

Problem është referuar në KZAZ e cila vendosi të shpallë të pavlefshme 6 fletët e votimit që u konstatuan tepër në kutinë përkatëse të votimit.